

**Bekim (Hamëz) Jashari**

**Kandidat i Pavarur për Kryetar Komune në Skënderaj**

### **DEKLARATË POLITIKE**

*Me këtë Deklaratë Politike, dëshmoj vullnetin tim personal dhe të drejtën për të kandiduar si Kandidat i Pavarur për Kryetar Komune në Komunën e Skënderajt në zgjedhjet Lokale të 22 tetorit, 2017.*

*Publikisht, deklaroj se nuk i përkas asnjë Partie Politike, asnjë Koalicioni Qytetar, asnjë Lëvizjeje. Me këtë prandaj, edhe nuk do ta mbështes asnjë parti, koalicion, lëvizjeje që garon për kreun e komunës në Skënderaj.*

*E njoftoj opinionin e gjerë se nuk mbaj funksion politik dhe nuk kam asnjë pengesë juridike-ligjore që do të më pengonte në synimin tim për të kandiduar.*

*E them me përgjegjësi morale dhe publike se, plotësoj të gjitha kushtet substanciale për të garuar në marrjen e kësaj përgjegjësie.*

*Në kontekst, deklaroj se fushatën do ta zhvilloj në pajtim me Kodin e Mirësjelljes të aprovuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe Partitë Politike.*

*Zotohem se, do të punojë me përkushtim për të mirën e qytetarëve, mirëqenien e tyre, dhe zhvillimin ekonomik të komunës ku do të garojë.*

*Kësaj deklarate, ia bashkëngjes të gjitha dokumentet e nevojshme që Kandidatura ime të jetë e ligjshme, dhe e aprovueshme.*

*Po ashtu, kësaj deklarate ia bashkëngjes edhe Listën e Zgjedhësve që më mbështesin me nënshkrimet e tyre.*

**Skënderaj, 22.8.2018**

